

UJËSJELLËSI I RI NË KRUIJË

Pas interpelancës së zhvilluar me banorët e Krujës në Platformën e Bashkëqeverisjes shqiperiaqeduam.al, ka nisur puna për ndërtimin e ujësjellësit të ri në bashkinë e Krujës. Ky investim do të sigurojë furnizim të pandërprerë dhe me cilësisë me ujë të pijshëm për 17.500 banorë, do të eliminojë humbjet dhe ndotjet e ujit në rrjet. Projekti parashikon gjithashtu edhe mbulimin me ujë të pijshëm të zonës së Sarisalltikut.

AMSTERDAM "IWW CONFERENCE"

Ministrja Belinda Balluku mori pjesë në konferencën "Java Botërore e Ujit", me përfaqësues nga politika si dhe specialistë të sektorit të ujit nga të gjitha vendet e botës. Në fokus të konferencës ishte zgjidhjet e integruara për menaxhimin e ujit. Ministrja Balluku bisedoi me aktivistë dhe specialistë që prej vitesh mbrojnë këtë kauzë globale. Qeveria Shqiptare po investon intensivisht në rritjen e kapaciteteve të shërbimit të ujësjellësive në mbarë vendin.

UJËSJELLËSI I RI NË RROGOZHINË

Në Bashkinë e Rrogozhinës po shkon drejt zgjidhjes mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm për banorët. Punimet për ndërtimin e ujësjellësit të ri kanë avancuar dhe pritet të jetë plotësisht në funksion vitin e ardhshëm, duke siguruar furnizim të pandërprerë me ujë të pijshëm për afro 12 mijë banorë. Ky projekt përfshin rinovimin tërësisht të rrjetit të transmetimit si dhe rrjetin e brendshëm.

AKTIVITET SENSIBILIZUES PËR UJIN

Në kuadër të Javës Kombëtare të Ujit në Shqipëri, Ministrja Belinda Balluku, së bashku me zëvendësministrin, Hantin Bonati dhe kreun e AKUM, Alqi Bllako, ishin në shkollën "E Kuqe" në Tiranë, ku biseduan me nxënës të kësaj shkolle rreth vlerave të ujit, por edhe rëndësisë së kursimit të tij. Krahas investimeve në infrastrukturën e ujësjellësive është tepër e rëndësishme edhe ndërgjegjësimi i të gjithë shoqërisë për një çështje kaq jetike, jo vetëm në Shqipëri por në të gjithë botën.

MOTI I KEQ, MIE NË GATISHMËRI

Si pasojë e motit të keq, që përfshiu vendin për tri ditë me radhë, strukturat e MIE dhe agjencitë e varësisë kaluan në gjendje gatishmërie, me qëllim zgjidhjen e situatave të vështira që mund të krijoheshin. Falë këtyre masave u bë e mundur një menaxhim i mirë duke mos penguar lëvizjen e qytetarëve apo edhe rikthimin e energjisë në kohë rekord në zonat më të prekura nga moti i keq.

NDËRHYRJE NË LINJË BULQIZË- VOJNIK

Grupet e punës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit ndërhyjnë në linjën Bulqizë-Vojnik për të zëvendësuar shtyllën 101N, e cila rrezikonte të rrëzohej nga kushtet atmosferike. Kjo ndërhyrje bëri të mundur edhe rritjen e sigurisë në unazën e linjave 110kV të Rajonit Verior.